



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Dragashit 01.nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, Kuvendi i komunës së Dragash-it, pasi shqyrtoi propozimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Dragashit, në Seancën e mbajtur më 17.08.2021 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 01 Nr.060/01-6697/2 I DATËS 29.04.2021 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE PËR NEVOJA TË VEÇANTA

- I. **APROVOHET** propozimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Dragash-it i cili ka për qëllim anulimin e Vendimit 01 Nr.060/01-6697/2 të datës 29.04.2021, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për nevoja të veçanta.
- II. Pas kërkesës së MAPL-së Nr.020-419/2 të datës 12.07.2021, për rishqyrtimin e Vendimit 01 Nr.060/01-6697/2 të datës 29.04.2021 për shkak të pamundësisë së plotësimit të kërkesave ligjore të kërkuara nga ana e MAPL-së, si dhe pas vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për shpalljen e zgjedhjeve lokale nr.44/2021 të datës 15.06.2021 si dhe shkresës njoftuese të MAPL-së me nr.013-554 të datës 18.06.2021 Kuvendi i Komunës së Dragash-it e anulon Vendimin e lartcekur.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragash-it.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Dragash-it z.Shaban Shabani,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë dhe
- Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH
01 Nr.060/1-17870/3

Dt.17.08.2021

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Dragash



Betim Merdiu